



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 01-3318/13
Br. Prot. 01-3318/13
Prot. No. 01-3318/13
Data 14.10.2013
Datum 14.10.2013
Date 14.10.2013

Nr. i faq 03
Broj stranica 03
Nr. folios 03

PRISHTINE

DATE/A:	14/10/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Ahmet Hasani Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit në Institucionin e Avokatit të Popullit
CC:	z. Sami KURTESHI Avokat i Popullit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtör i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: Furnizim me dy Automjete të Udhëtarëve /Vetura për Nevoja të IAP-it Lot I

Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizim me dy Automjete të Udhëtarëve /Vetura për Nevoja të IAP-it Lot I", me nr. të prokurimit: 321 13 028 121, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si "Autoritet Kontraktues", që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizim me dy Automjete të Udhëtarëve /Vetura për Nevoja të IAP-it Lot I" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues IAP (Institucioni i Avokatit të Popullit) që të jetë pjesë e monitorimit për tenderin me titull: “Furnizim me dy Automjete të Udhëtarëve/Vetura për Nevoja të IAP-it Lot I” me nr. prokurimi: 321-13-028-121.

Më datë 06/06/2013 Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë publikimin në web faqen e KRPP-së “Furnizim me dy Automjete të Udhëtarëve/ Vetura për Nevoja të IAP-it, ky aktivitet ishte i ndarë në dy LOTE. Autoriteti Kontraktues ka shpallur “Njoftim për Anulim” më datë 19/06/2013, për shkak të disa gabimeve në specifikacionin teknik duke e cekur që ky aktivitet i prokurimit do të rishpallet menjëherë. Ky aktivitet është shpallur për herë të dytë më datë 20/06/2013, ku më 23/07/2013 është bërë njoftimi për anulim të këtij aktiviteti ngaqë është pranuar vetëm një ofertë për Lot I, ndërsa për Lot II është shpallur fitues HYUNDAI AUTO SHPK . Institucioni i Avokatit të Popullit përsëri më datë 15/08/2013 bëri shpalljen për këtë aktivitet të prokurimit ku më datë 02/09/2013 bëri përsëri anulimin e këtij aktiviteti të Prokurimit për arsye se është pranuar vetëm një ofertë/tender për LOT I. Më datë 12/09/2013 në web faqen e KRPP-së është bërë publikimi “Njoftim për Kontratë-Ritender”, “Furnizim me dy Automjete të Udhëtarëve/Vetura për Nevoja të IAP-it Lot I” **për herë të katër**. Në këtë aktivitet të prokurimit “Dosjen e Tenderit “ e kanë tërhequr gjithsej tetë Operator Ekonomik: Reception LTG Kosova sh.p.k., Autoteknik Baholli sh.p.k., Auto Mita, Mercom Company sh.p.k., Hyundai Auto sh.p.k., LTG Land Rover Kosova Sh.p.k., Auto Gjikkoili sh.p.k., Allmakes Global Services-AGS.

Ndërsa “Dosjen e Tenderit” e kanë dorëzuar vetëm dy Operator Ekonomik: Hyundai Auto sh.p.k dhe Allmakes Global Services- AGS.

Autoriteti Kontraktues do të parashtroj në “Dosjen e Tenderit” të gjitha “Specifikimet Teknike” të cilat çdo tenderues duhet ti përmbush. Specifikimet Teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë në mënyrë jo-diskriminuese karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës. Autoriteti Kontraktues të tregojë nëse “Specifikimet Teknike” të parashtruara janë obligative apo kërkesa minimale. “Specifikimet Teknike” duhet të jenë të qarta, të sakta dhe precize në mënyrë që të mos paraqesin kufizime të panevojshme në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave.

Në “Dosja e Tenderit” e përpiluar nga Autoriteti Kontraktues tek pika 6.4-I.- Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik është cekur Afati i liferimit më së voni deri më 12/12/2013 ndërsa tek pika 7.1 Kërkesat e përshtatshmërisë Profesionale tek pika 9. Afati i liferimit më së voni deri më 16/12/2013, në “Njoftim për Kontratë” të publikuar në web faqen e KRPP me 12/09/2013 afati i liferimit është 12/12/2013. Po ashtu në “Dosja e Tenderit” pjesa C FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT Titulli i Kontratës është :”Furnizim me një veturë për nevoja të AKK- së”. Autoriteti kontraktues duhet të përpiloj “Dosjen e Tenderit” dhe “Njoftim për Kontratë” që ofrojnë informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, bien ndesh me nenin 28 Specifikimet Teknike dhe nenin 27 Dosja e Tenderit të ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, dhe nenin 18 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik

Konsiderojmë se një shkelje e tillë nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktikat e tilla në të ardhmen.

Me respekt!

10.05.2019